

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

Data: **30.07.2026**

Drejtuar: “Luar Bros” sh.p.k me NIPT L72322004M

Operatorit Ekonomik (OE) **X** ose

Operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k me NIPT L72322004M dhe adresë: Rruga “Ali Demi”
, Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11, Tiranë

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Mall**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E Hapur**

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **REF-91082-06-24-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje kosha dhe stola”.**

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **22.07.2026**

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **Buletini Nr.47, datë 27.07.2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k me NIPT L72322004M

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **12,110,000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik “ERALD” SH.P.K , NIPT J74517205P

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **10,202,000 (dhjetë milionë e dyqind e dy mijë) lekë pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori ekonomik “R. S. &M” SH.P.K, NIPT K32203002I

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **12,445,000 (dymbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë pa TVSH.**

.

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori ekonomik “ARTEO 2018” SH.P.K, NIPT L82523203F

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SH.P.K, NIPT K71820009I

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **8,098,500 (tetë milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.**

.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OPERATORI EKONOMIK “ERALD” SH.P.K, NIPT J74517205P.

arsyet: 1.Operatori ekonomik skualifikohet sepse nuk përmbush kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të kualifikimit të dst ku percaktohet “Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, autorizim distributori, marrëveshje bashkëpunimi, kontratë furnizimi ose dokument tjetër ekuivalent, që provon të drejtën e operatorit ekonomik për të ofruar dhe furnizuar produktet objekt prokurimi.

Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që provon lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues, duhet të deklarojë këtë fakt dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës që provon prodhimin e artikujve objekt prokurimi ose të artikujve të ngjashëm”. Ne përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin e emertuar “Deklarate_NT” ku ka deklaruar për artikujt “Stol dekorativ me krahë gize” dhe “Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri” se “.....me cilesinë Administratorit të operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k deklaroj se jam prodhues i mobiljeve si më poshtë vijon:

Nr Emërtimi I artikullit Njësia Sasia Origjina e mallit

1 Stol dekorativ me krahë gize copë 350 "Erald" sh.p.k, Qerekë, Krujë, Shqipëri, konform CE

2 Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri copë 49 "Erald" sh.p.k, Qerekë, Krujë, Shqipëri, konform CE”

Ndersa, ka deklaruar se “.....me cilesinë Administratorit të operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k deklaroj se jam tregtar i mobiljeve si më poshtë vijon:

Nr Emërtimi I artikullit Njësia Sasia Origjina e mallit

1 Kosh plastik për mbetje urbane 120 L copë 30 "Gjermani, konform CE”,

por nuk ka deklaruar asnjë prodhues të këtij artikulli si dhe nuk ka paraqitur në SPE autorizim prodhuesi apo distributori të autorizuar për këto artikull.

2. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3 të kapacitetit teknik, të përcaktuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST-së, ku kërkohet: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog teknik/broshurë të lëshuar nga prodhuesi/t, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat që oferton, si dhe specifikimet përkatëse të tyre, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Katalogu/broshura teknike duhet të përmbajë elementë të qartë dhe autentikë të prodhuesit/markës, si: logo, ëbsite, e-mail, numër telefoni, adresë ose të dhëna të tjera identifikuese, me qëllim verifikimin e burimit të dokumentit dhe lidhjen e tij me produktin e ofertuar.

Në rast se paraqiten fragmente katalogu/broshure, ato duhet të tregojnë qartë se janë pjesë e katalogut/broshurës përkatëse, si dhe cilit produkt, modeli, marke ose prodhuesi i përkasin.

Mosparaqitja e katalogut/broshurës teknike, ose paraqitja e dokumentacionit nga i cili nuk identifikohet qartë produkti i ofertuar dhe prodhuesi/marka përkatëse, do të përbëjë shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.”

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentet “Katalog Artikulli Erald”, për artikujt “Stol dekorativ me krahë gize” dhe “Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri”, “Katalog_artikulli_02”, për artikullin “Kosh plastik për mbetje urbane 120 L”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohen mangësitë e mëposhtme:

1. Dokumentet riprodhojnë specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor

Përmbajtja e dokumenteve rezulton të jetë kryesisht riprodhim i specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, duke përdorur formulime të tilla si “rreth”, “jo më pak se”, “ $\pm 2\%$ ”, “ $\pm 3\%$ ”, “ose ekuivalent”, “ose material tjetër ekuivalent”, “sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor” dhe formulime të tjera normative. Këto përcaktime paraqesin kërkesat dhe tolerancat e lejuara nga Autoriteti Kontraktor, por nuk përfaqësojnë karakteristikat teknike konkrete të produkteve të prodhuara dhe të ofertuar nga operatori ekonomik. Një katalog ose broshurë teknike e prodhuesit duhet të përmbajë të dhëna konkrete për produktin e ofertuar, si modeli, kodi, përmasat reale, materialet konkrete, parametrat teknikë dhe karakteristikat përfundimtare të tij.

2. Nuk identifikohen produktet konkrete të ofertuar

Në dokumentacionin e paraqitur nuk përcaktohen qartë, për secilin artikull, modeli, kodi ose referenca, seria ose tipi, emërtimi tregtar apo referenca e katalogut. Për rrjedhojë, dokumentacioni nuk mundëson identifikimin e qartë dhe të dallueshëm të mallrave të ofertuar dhe lidhjen e tyre me parametrat teknikë të deklaruar, siç kërkohet shprehimisht në kriterin 2.3.3.

3. Fotografitë dhe skicat nuk provojnë produktet konkrete të ofertuar

Fotografitë dhe skicat e përfshira në dokumentin “*Katalog_Artikulli_Erald*” rezultojnë të jenë të njëjtat foto/skica ilustrative të ngarkuara në SPE nga Autoriteti Kontraktor së bashku me specifikimet teknike. Për pasojë, ato nuk përbëjnë fotografi apo materiale katalogu të prodhuesit “ERALD” sh.p.k. dhe nuk provojnë se produktet e paraqitura janë produktet konkrete që operatori ekonomik prodhon dhe oferton. Ato nuk shoqërohen me model, kod produkti, referencë prodhimi ose emërtim tregtar që t’i lidhë drejtpërdrejt me mallrat konkretë të ofertuar. Edhe për artikullin “*Kosh plastik për mbetje urbane 120 L*”, fotografitë paraqesin produkte me logon “SULO”, por nuk jepet modeli, kodi ose referenca që të provojë lidhjen ndërmjet fotografive dhe produktit konkret të ofertuar.

Mangësitë specifike sipas artikujve

A. “*Stol dekorativ me krahë gize*”

Për këtë artikull, prodhuesi është i identifikueshëm si shoqëria “ERALD” sh.p.k., pasi operatori ekonomik ofertues është njëkohësisht prodhues dhe dokumenti mban logon dhe vulën e tij. Megjithatë, nuk identifikohet produkti konkret i prodhuar dhe i ofertuar. Dokumenti nuk jep modelin ose kodin e stolit, përmasat reale përfundimtare, llojin konkret të drurit, llojin konkret të metalit/gizës, përmasat reale dhe numrin përfundimtar të ristelave, tipin real të vidave dhe elementëve të fiksimit, si dhe llojin konkret të bojës, astarit dhe llakut që do të përdoren. Në vend të parametrave konkretë përdoren formulime alternative dhe orientuese, si “dru lisi ose dru tjetër ekuivalent”, “gizë ose material tjetër metalik ekuivalent”, “rreth 1320 mm $\pm 3\%$ ” dhe “ose zgjidhje tjetër ekuivalente”. Për rrjedhojë, nuk mund të verifikohet produkti konkret që operatori ekonomik angazhohet të furnizojë.

B. “*Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri*”

Edhe për këtë artikull, shoqëria “ERALD” sh.p.k. është e identifikueshme si prodhuese, por nuk identifikohet modeli ose produkti konkret. Dokumenti nuk deklaron në mënyrë të përcaktuar modelin ose kodin e koshit, përmasat reale të produktit, kapacitetin konkret të koshit të brendshëm, llojin konkret të drurit, materialin konkret të strukturës metalike, trashësinë reale të llamarinës së strukturës dhe të koshit të brendshëm, sistemin konkret të derës, menteshave dhe mbylljes, si dhe llojin konkret të trajtimit mbrojtës të drurit dhe metalit. Përdorimi i formulimeve “rreth”, “ $\pm 3\%$ ”, “ose material tjetër ekuivalent” dhe “ose sistem tjetër ekuivalent” nuk mundëson verifikimin e karakteristikave reale të produktit të ofertuar.

C. “*Kosh plastik për mbetje urbane 120 L*”

Dokumentin i ngarkuar në SPE nuk përmban logo autentike të hartuesit ose prodhuesit të dokumentit, ëbsite, adresë e-mail, numër telefoni, adresë të selisë apo të dhëna të tjera identifikuese të prodhuesit ose burimit të dokumentit. Megjithëse në fotografi shfaqet emërtimi “SULO”, nuk deklarohet shprehimisht se ky është prodhuesi i produktit të ofertuar dhe nuk identifikohet modeli konkret 120 L. Gjithashtu, mungojnë dimensionet konkrete të produktit, si lartësia, gjerësia, thellësia, dimensionet e trupit dhe dimensionet me kapak. Në seksionin “Dimensionet e koshit plastik” është përsëritur vetëm toleranca e lejuar nga DST-ja dhe nuk janë deklaruar vlerat reale të produktit. Po kështu, parametrat si pesha, peshëmbajtja, masa totale e lejueshme, diametri i rrotave, gjatësia e aksit dhe diapazoni i temperaturave paraqiten në formën e kërkesave minimale ose orientuese të AK-së dhe jo si vlera konkrete të produktit të ofertuar.

3. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dst ku përcaktohet “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për zërat objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kërkesë Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanisë prodhuese, adresa, eëbsite	Emertimi i katalogut	Kodi i produktit ose nr. faqes në katalog.
----	-----------------------	---	----------------------	--

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

Operatori ekonomik duhet të plotësojë emrin, adresën dhe eëbsite-in e kompanisë prodhuese, emërtimin e katalogut/broshurës/skedës teknike të prodhuesit, si dhe referencën në katalog, kodin e produktit ose numrin e faqes ku gjenden specifikimet teknike të produktit të ofertuar.

Në rast se produkti nuk ka kod të veçantë në katalog, operatori ekonomik duhet të plotësojë numrin e faqes ose referencën përkatëse në dokumentacionin teknik, ku Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë specifikimet e plota teknike të produktit të ofertuar” duke qenë se nuk ka paraqitur asnjë dokument në përmbushje të këtij kriteri.

4. Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k. nuk përmbush kriterin 2.3.4 të kapacitetit teknik, ku përcaktohet:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmërinë e produkteve të ofruara me standardet, normat ose referencat teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi. Në përmbushje të kësaj pike, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata konformiteti, deklarata konformiteti, deklarata performance, raporte testimi ose dokumentacion tjetër ekuivalent, të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione/organe të pavarura të akredituara, sipas rastit, nga ku të vërtetohet përputhshmëria e produkteve të ofruara me standardet, normat ose referencat teknike të kërkuara në shtojcën e specifikimeve teknike.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE konstatohet se operatori ekonomik **nuk ka paraqitur asnjë dokument në përmbushje të këtij kriteri.**

Për rrjedhojë, nuk mund të verifikohet përputhshmëria e produkteve të ofertuar me standardet, normat dhe referencat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Për këtë arsye, operatori ekonomik **“ERALD” sh.p.k. nuk përmbush kriterin 2.3.4**

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k. nuk ka provuar përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, konkretisht kriterëve 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4 të Dokumenteve të Tenderit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi, autorizim distributori ose dokument tjetër ekuivalent për artikullin “Kosh plastik për mbetje urbane 120 L”, për të cilin nuk rezulton prodhues; nuk ka paraqitur katalogë/broshura teknike që identifikojnë qartë produktet konkrete të ofertuara dhe karakteristikat e tyre teknike, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit; si dhe nuk ka paraqitur certifikata konformiteti, deklarata konformiteti, raporte testimi ose dokumentacion tjetër ekuivalent që të vërtetojë përputhshmërinë e produkteve të ofertuara me standardet, normat ose referencat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Për rrjedhojë, oferta e operatorit

ekonomik “ERALD” sh.p.k. nuk konsiderohet ofertë e vlefshme në kuptim të nenit 92, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe operatori ekonomik skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OPERATORI EKONOMIK “R. S. &M” SH.P.K, NIPT K32203002I.

Arsyet: 1. Operatori ekonomik skualifikohet sepse nuk përmbush pikën 1, germa “b”, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet paraqitja e “Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës sipas formatit dhe vlerës së kërkuar në dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 1, germa “b”, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit dhe skualifikohet nga procedura.

2. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.6 të kapacitetit teknik, ku përcaktohet se operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga 1 (një) copë mostër për secilin nga artikujt objekt prokurimi: “Stol dekorativ me krahë gize”, “Kosh plastik për mbetje urbane 120 L” dhe “Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri”.

Nga verifikimi i procesit të administrimit të mostrave konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, asnjë nga mostrat e kërkuara për artikujt objekt prokurimi.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor nuk ka pasur mundësi të verifikojë përputhshmërinë fizike të produkteve të ofertuar me ofertën teknike, katalogët, skedat teknike dhe specifikimet teknike të DST-së. Në kushtet kur kriteri 2.3.6 përcakton shprehimisht se mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim, operatori ekonomik nuk përmbush këtë kriter dhe skualifikohet nga procedura.

3. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik, ku kërkohet që, në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, të paraqesë autorizim prodhuesi, autorizim distributori, marrëveshje bashkëpunimi, kontratë furnizimi ose dokument tjetër ekuivalent që provon të drejtën për të ofruar dhe furnizuar produktet objekt prokurimi.

Në përmbushje të këtij kriteri, për artikullin “Kosh plastik për mbetje urbane 120 L”, operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi të lëshuar nga shoqëria “Kappa Gepard” sh.p.k. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti konstatohet se autorizimi i referohet procedurës me nr. REF-78812-03-10-2026, ndërsa procedura në shqyrtim ka nr. REF-91082-06-24-2026.

Për rrjedhojë, dokumenti i paraqitur nuk provon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë të drejtën e operatorit ekonomik për të ofertuar dhe furnizuar produktin në procedurën konkrete dhe operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik.

4. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3 të kapacitetit teknik, pasi dokumentacioni teknik i paraqitur nuk mundëson identifikimin e qartë dhe të njëtrajtshëm të prodhuesit të produktit konkret.

Në deklaratën e prodhuesit, operatori ekonomik deklaron se është prodhues për artikujt “Stol dekorativ me krahë gize” dhe “Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri”. Ndërkohë, katalogu teknik i paraqitur nga operatori përfshin edhe artikullin “Kosh plastik për mbetje urbane 120 L”, me kod produkti RSM-KP-120L, ndërsa për këtë artikull është paraqitur autorizim nga një prodhues tjetër.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur krijon paqartësi lidhur me prodhuesin real të koshit plastik, burimin e katalogut dhe lidhjen ndërmjet produktit të ofertuar, prodhuesit dhe dokumentacionit teknik përkatës. Në këto kushte, nuk mund të kryhet verifikimi i qartë dhe objektiv i produktit të ofertuar, ndaj operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3 të kapacitetit teknik.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OPERATORI EKONOMIK “ARTEO 2018” SH.P.K, NIPT L82523203F.

Arsyet: Operatori ekonomik “ARTEO 2018” sh.p.k. skualifikohet, pasi nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokumentacion për kualifikim, sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, dhe as ofertë ekonomike. Për rrjedhojë, nuk mund të verifikohet përmbushja e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. OPERATORI EKONOMIK “LEON KONSTRUKSION” SH.P.K, NIPT K71820009I.

Arsyet: OE skualifikohet për ofertë anomalisht të ulët. Në zbatim të nenit 93, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 16/2024, për procedurat e prokurimit

me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, kur një ofertë konstatohet anomalisht e ulët, autoriteti kontraktor e refuzon atë pa kërkuar shpjegime nga operatori ekonomik. Pra, në këto procedura, ligji nuk parashikon fazë sqarimi apo justifikimi të ofertës anomalisht të ulët, por vendos detyrimin e drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktor për refuzimin e saj.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 82, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët. Sipas kësaj dispozite, kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse është ulur më shumë se 25% nga fondi limit i përlogaritur.

Në rastin konkret, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të ofertave të vlefshme, rezulton se në procedurë janë dy oferta të vlefshme, përkatësisht oferta e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k. në vlerën 8,098,500 lekë pa TVSH dhe oferta e operatorit ekonomik “Luar Bros” sh.p.k. në vlerën 12,110,000 lekë pa TVSH. Për rrjedhojë, për vlerësimin e ofertës anomalisht të ulët zbatohet kufiri prej 25% i fondit limit.

Fondi limit i procedurës është 12,481,665.40 lekë pa TVSH.

25% e fondit limit është:

$12,481,665.40 \text{ lekë} \times 25\% = 3,120,416.35 \text{ lekë}$

Kufiri minimal i pranueshëm është:

$12,481,665.40 \text{ lekë} - 3,120,416.35 \text{ lekë} = 9,361,249.05 \text{ lekë pa TVSH}$

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k. është:

8,098,500 lekë pa TVSH

Kjo ofertë është më e ulët se kufiri minimal i pranueshëm:

$9,361,249.05 \text{ lekë} - 8,098,500 \text{ lekë} = 1,262,749.05 \text{ lekë}$

Për rrjedhojë, oferta e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k. rezulton 1,262,749.05 lekë më e ulët se kufiri minimal i pranueshëm, duke u ulur më shumë se 25% nga fondi limit. Në këto kushte, oferta vlerësohet anomalisht e ulët.

Duke qenë se procedura është me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, në zbatim të nenit 93, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor nuk ka detyrimin dhe as mundësinë procedurale t’i kërkojë operatorit ekonomik shpjegime për ofertën e paraqitur. Përkundrazi, dispozita ligjore urdhëron refuzimin e ofertës anomalisht të ulët pa kërkuar shpjegime.

Për sa më sipër, oferta e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k., në vlerën 8,098,500 lekë pa TVSH, refuzohet si ofertë anomalisht e ulët dhe operatori ekonomik skualifikohet nga procedura.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Luar Bros” sh.p.k me NIPT L72322004M** dhe me adresë: Adresë: Rruga “Ali Demi” , Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11, Tiranë , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **12,110,000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH.**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj, e dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **249,633.31** (dyqind e dyzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e një) lekë, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)